

URDHËR
Nr. 460, datë 8.9.2016

PËR MBYLLJEN E VEPRIMTARISË SË SHKOLLËS SË MESME JOPUBLIKE,
ARSIMI I MESËM I PËRGJITHSHËM (GJIMNAZ), “SKËNDERBEJ”

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 70, të ligjit nr. 69/2012, datë 21.6.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”.

URDHËROJ:

1. Mbylljen e veprimtarisë së shkollës së mesme jopublike, arsimit i mesëm i përgjithshëm (gjimnaz), “Skënderbej”.

2. Institucioni arsimor i përcaktuar në pikën 1 të këtij urdhri, ka këto detyrime:

a) Të mbyllë të gjitha detyrimet lidhur me veprimtarinë mësimore për vitin akademik 2015–2016, brenda afateve të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;

b) Të pajisë çdo nxënës me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm shkollor, që do të shërbejë për transferimin e tij në një institucion tjetër të arsimit parauniversitar, brenda datës 9.9.2016;

c) Të vërë në dispozicion të njësisë arsimore vendore përkatëse, çdo informacion të kërkuar dhe të komunikojnë me to deri në plotësimin dhe mbylljen e të gjitha kërkesave të përcaktuara në këtë urdhër;

d) Të kthejë pagesat e kryera nga nxënësit për pjesën e papërfunduar të shkollimit, si dhe çdo detyrim tjetër të papërmbytur që mund të kenë ndaj nxënësit;

e) Të dorëzojë në njësinë arsimore vendore përkatëse të gjithë dokumentacionin lidhur me veprimtarinë mësimore të kryer;

f) Të gjitha shpenzimet për kryerjen e proce-durave për transferimin e nxënësve në zbatim të këtij urdhri, të përballohen nga institucioni përkatës i arsimit parauniversitar privat.

3. Njësitë arsimore vendore kanë për detyrë:

a) Të ngrenë brenda datës 9.9.2016 një grup pune për ndjekjen e zbatimit të këtij urdhri nga institucioni i përcaktuar në pikën 1. Grupi i punës të menaxhojë transferimin e nxënësve në institucione të tjera të arsimit parauniversitar publik ose privat;

b) Të ruajnë në arkivin e tyre dhe në vijim të arkivojnë sipas ligjit për arkivat, të gjithë dokumentacionin e dorëzuar nga institucioni i përcaktuar në pikën 1 të këtij urdhri.

4. Ministria e Arsimit dhe Sportit të marrë të gjitha masat sipas parashikimeve të Kodit Civil, të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, si dhe akteve ligjore e nënligjore në fuqi për personin juridik, që përfaqëson institucionin e përcaktuar në pikën 1, i cili nuk zbaton këtë urdhër.

5. Ministria e Arsimit dhe Sportit, t’i kërkojë Qendrës Kombëtare të Licencimit kryerjen e veprimeve ligjore për çregjistrimin e subjekteve në fjalë.

6. Ngarkohen për zbatimin e urdhrit: Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit Parauniversitar, njësitë arsimore vendore përkatëse dhe subjekti juridik përfaqësues i institucionit, i përcaktuar në pikën 1 të këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT
Lindita Nikolla